FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.17 18 shkurt 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9863 datë 28.1.2008	Për ushqimin ……	581
Ligj nr.9864 datë 28.1.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9426, datë 6.10.2005 "Për mbarështimin e blegtorisë" ……	608
Ligj nr.9865 datë 31.1.2008	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për disa çështje ekonomike dhe tatimore" ……	612
Vendim i KM nr.109, datë 3.2.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Maminas të qarkut të Durrësit ……..	615

LIGJ
Nr.9863, datë 28.1.2008

PËR USHQIMIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të vendosë bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesat e konsumatorit, duke përcaktuar:

a) kërkesat dhe parimet e përgjithshme për higjienën dhe sigurinë e ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë;

b) detyrimet e operatorëve të biznesit të ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë, për higjienën dhe sigurinë e këtyre ushqimeve;

c) kërkesat e përgjithshme për cilësinë e ushqimeve;

ç) kërkesat e përgjithshme për regjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emërtimin e origjinës së kontrolluar;

d) kërkesat e përgjithshme për mënyrën e etiketimit të ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë;

dh) kërkesat e përgjithshme të nxjerrjes në treg të ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë;

e) kërkesat e përgjithshme të nxjerrjes në treg të ushqimeve të reja dhe të ushqimeve të reja për kafshë;

ë) sistemin e kontrollit zyrtar të ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë;

f) sistemin e laboratorëve të autorizuar për analiza dhe të laboratorëve të referencës;

g) menaxhimin e krizës dhe të emergjencave;

gj) krijimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;

h) përgjegjësitë e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, të prodhuara në Republikën e Shqipërisë ose të importuara dhe të nxjerra në treg në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet në prodhimin primar dhe në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë.

2. Ky ligj nuk zbatohet për ushqimet e prodhuara, të përgatitura, të përpunuara dhe të grumbulluara për qëllime përdorimi vetijak, të cilat nuk janë të destinuara për t'u nxjerrë në treg.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ushqim" ose "produkt ushqimor" është çdo substancë ose produkt i përpunuar, pjesërisht i përpunuar ose i papërpunuar, i përcaktuar të jetë ose, për ndonjë arsye, është i konsumueshëm për

njerëz.

Termi “ushqim” përfshin, gjithashtu, pijet, çamçakëzin, aditivët ushqimorë dhe çdo substancë tjetër që, në mënyrë të qëllimshme, bëhet pjesë e ushqimit gjatë përpunimit, përgatitjes ose trajtimit.

Termi “ushqim” përfshin edhe ujin:

a) të përdorur si ujë të pijshëm për furnizimin publik të popullsisë;

b) të përdorur dhe/ose të bashkuar në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij;

c) të paketuar si ujë tryeze, ujë mineral dhe ujë burimi.

Termi “ushqim” nuk përfshin:

a) ushqimin për kafshë;

b) kafshët e gjalla, me përjashtim të rasteve kur janë përcaktuar për konsum njerëzor;

c) bimët dhe frutat, përpara korrjes ose vjeljes;

ç) produktet mjekësore;

d) produktet kozmetike;

dh) duhanin dhe cigaret;

e) substancat narkotike dhe psikotrope;

ë) mbetjet, kontaminuesit, si dhe përbërësit natyrorë të bimëve dhe kafshëve, që shkaktojnë efekt të kundërt në shëndetin e njerëzve.

2. “Biznes ushqimor” është çdo veprimtari e ndërmarrë për qëllime përfitimi ose jo, publike ose private, për prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen e ushqimit.

3. “Operator i biznesit ushqimor” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar për të kryer veprimtari, që lidhen me biznesin ushqimor, përgjegjës për të siguruar se kërkesat e ligjit të ushqimit janë arritur në biznesin ushqimor të kontrolluar prej tij.

4. “Ushqim për kafshë” (ose produkt ushqimor për kafshë) është çdo substancë ose produkt, përfshirë aditivët, i përpunuar, pjesërisht i përpunuar ose i papërpunuar, i përcaktuar për t’u përdorur për ushqim për kafshë që prodhojnë ushqim.

5. “Biznes i ushqimit për kafshë” është çdo veprimtari e ndërmarrë për qëllime përfitimi ose jo, publike ose private, në prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen e ushqimeve për kafshë, përfshirë veprimtarinë e çdo prodhuesi që prodhon, përpunon, ruan ose transporton ushqime për ushqyerjen e kafshëve të fermës së vet.

6. “Operator i biznesit ushqimor për kafshë” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar për të kryer veprimtari, që lidhen me biznesin e ushqimit për kafshë, përgjegjës për të siguruar se kërkesat e ligjit të ushqimit janë plotësuar në biznesin e kontrolluar prej tij.

7. “Shitje” është trajtimi dhe/ose përpunimi i ushqimeve dhe ruajtja e tyre në pikat e shitjes me pakicë ose të shpërndarjes te konsumatori i fundit, ku përfshihen rrugët e shpërndarjes, operatorët e kuzhinave, kantinat, kuzhinat institucionale, restorantet dhe shërbimet operative të ngjashme të ushqimit, dyqanet, supermarketet, qendrat e shpërndarjes dhe të shitjes me shumicë.

8. “Vendosje në treg” është mbajtja e ushqimeve dhe e ushqimeve për kafshë për qëllime shitjeje, ku përfshihen ofrimi për shitje ose ndonjë formë tjetër transferimi, me ose pa pagesë, si dhe shitja, shpërndarja dhe forma të tjera transferimi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. “Risk” është mundësia e një efekti të kundërt në shëndet dhe ashpërsia e këtij efekti, si rrjedhojë e pranisë së një ose më shumë dëmtuesve në ushqim.

10. “Analizë risku” është një proces që ka lidhje me tre komponentë të ndërthurur me njëri-tjetrin, që janë: vlerësimi i riskut, menaxhimi i riskut dhe komunikimi i riskut.

11. “Vlerësim i riskut” është një proces i bazuar shkencërisht, me katër etapa: identifikimi i dëmtuesit, karakterizimi i dëmtuesit, vlerësimi i ekspozimit dhe karakterizimi i riskut.

12. “Menaxhim i riskut” është procesi, i ndarë nga vlerësimi i riskut, i vlerësimit të politikave alternative në këshillim me subjektet e interesuara, duke pasur parasysh vlerësimin e riskut dhe faktorët e tjerë të pranueshëm. Nëse është e nevojshme, kihen parasysh edhe zgjedhja e mundësive të përshtatshme parandaluese dhe ato të kontrollit.

13. “Komunikim i riskut” janë shkëmbimet e ndërsjella të informacionit dhe të mendimeve gjatë procesit të analizimit të riskut për dëmtuesit dhe risqet, faktorët e lidhur me riskun dhe perceptimin e tij. Kjo bëhet nëpërmjet vlerësuesve të riskut, menaxherëve të riskut, konsumatorëve, biznesit të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, komunitetit akademik dhe aktorëve të tjerë të interesuar, duke shpjeguar vlerësimin e riskut të gjetur dhe bazën e vendimeve të menaxhimit të riskut.

14. “Dëmtues” është një agjent biologjik, kimik apo fizik, ose kushtet e ushqimit apo të ushqimit për kafshë, potenciale për të shkaktuar një efekt të dëmshëm në shëndetin e njerëzve.

15. “Gjurmim” është aftësia për të gjurmuar dhe ndjekur një ushqim, ushqim për kafshë, kafshët që prodhojnë ushqim, ose substanca të përcaktuara, që janë ose priten të jenë të lidhura me një ushqim për njerëz ose kafshë, në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes.

16. “Faza të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes” është çdo fazë, përfshirë importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar dhe, në mënyrë të ngjashme, importimin, prodhimin, ruajtjen, transportin, shpërndarjen, shitjen dhe furnizimin e ushqimeve për kafshë.

17. “Prodhim primar” (ose prodhim i parë) është prodhimi, rritja e lëndëve të para, ku përfshihen kultivimi, korrja, vjelja, mjelja dhe rritja e kafshëve në ferma, të destinuara për t’u therur, si dhe gjuetia, peshkimi dhe mbledhja e bimëve të egra.

18. “Konsumator i fundit” është konsumatori i fundit i produkteve ushqimore, që nuk e përdor ushqimin si pjesë të biznesit ushqimor.

19. “Kontroll zyrtar” është çdo kontroll, për të përcaktuar nëse kërkesat e ligjit të ushqimit janë plotësuar.

20. “Siguri ushqimore” është garancia se ushqimi nuk shkakton efekte të dëmshme në shëndetin e njerëzve, nëse është përgatitur dhe konsumuar, sipas kushteve të përdorimit.

21. “Higjienë e ushqimit” është tërësia e masave dhe e kushteve të nevojshme për kontrollin e dëmtuesve, për të siguruar përshtatshmërinë për konsum njerëzor të një produkti ushqimor, duke pasur parasysh përdorimin e përcaktuar të tij.

22. “Siguri ushqimore për ushqimin për kafshë” është garancia e ushqimeve, që përdoren për kafshët, që prodhojnë ushqime për njerëz, për praninë e disa substancave biologjike, kimike ose fizike në ushqim.

23. “Kontaminant” ose “substancë e dëmshme” është një agjent biologjik, kimik apo fizik, ose kushte të ushqimit apo ushqimit për kafshë, me mundësi për të shkaktuar një efekt të kundërt në shëndet.

24. “Mbetje” ose “substancë që mbetet” është substanca biologjike ose kimike, që është lejuar të përdoret në sasi dhe faza të caktuara të prodhimit primar të ushqimit, si dhe mbetjet metabolite dhe produktet e dekompozimit të tyre. Në mbetje nuk përfshihen aditivët ushqimorë.

25. “Aditiv ushqimor” është çdo substancë, e cila normalisht nuk konsumohet, nuk është një përbërës tipik i ushqimit, nuk ka vlera ushqimore dhe është shtuar qëllimisht për të përcaktuar karakteristikat teknologjike dhe organo-leptike të ushqimit gjatë përgatitjes, trajtimit, përpunimit, formimit, paketimit, transportit ose ruajtjes.

26. “Aditiv ushqimor për ushqime për kafshë” është çdo substancë, e cila bashkëvepron me ushqimin për kafshë dhe që mund të ndikojë në karakteristikat e ushqimit apo prodhimin e kafshëve që prodhojnë ushqim, ose kafshët e përdorura për prodhimin e ushqimit të përcaktuar për konsum njerëzor.

27. “Cilësi e ushqimeve” janë karakteristikat e veçanta të ushqimit, të cilat kënaqin kërkesat e konsumatorit të fundit.

28. “Etiketim” është çdo fjalë, pamje, markë tregtare, emër tregtar, konfigurim apo simbol për një ushqim, që vendoset mbi çdo paketim, dokument, njoftim, etiketë, unazë ose mbajtëse, që shoqëron apo i referohet një ushqimi të caktuar.

29. “Materiale në kontakt me ushqimin” janë aksesorët, pajisjet dhe materialet e tjera, të përdorura në biznesin e ushqimit, që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimin.

30. “Ushqime të reja” janë ushqimet ose përbërësit ushqimorë, që nuk kanë qenë përdorur më parë për konsum njerëzor në territorin e Republikës së Shqipërisë.

31. “Organizëm i modifikuar gjenetikisht” është çdo organizëm i gjallë, që zotëron një kombinim të ri të materialit gjenetik, që përftohet nëpërmjet përdorimit të bioteknologjisë moderne.

32. “Ushqim për nevoja të veçanta dietetike” është një ushqim me përbërje të veçantë ose një mënyrë e veçantë prodhimi, i ndryshëm nga ushqimi i zakonshëm, për shkak të karakteristikave ushqimore. Këto ushqime mund të parashikohen për përdorim te fëmijët deri 12 muaj dhe fëmijët e vegjël, te njerëzit me çrregullime të aparatit tretës ose të metabolizmit dhe te personat, të cilët janë në gjendje të veçantë fiziologjike, për të cilët është e nevojshme të arrihen efekte të veçanta nga një marrje e kontrolluar e disa përbërësve ushqimorë.

33. “Lëndë e parë” janë produktet dhe nënproduktet me origjinë bimore, shtazore dhe minerale (përfshirë edhe ujin e pijshëm), që përdoren për përftimin e produkteve ushqimore.

34. “Stabiliment” është çdo mjedis, ku zhvillohet biznesi ushqimor dhe/ose biznesi ushqimor për kafshë.

35. “Legjislacion ushqimor” janë ligjet dhe aktet nënligjore, që trajtojnë problemet e ushqimeve, në përgjithësi, dhe të sigurisë ushqimore, në veçanti. Ky legjislacion përfshin çdo fazë të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit e të ushqimit për kafshë, që prodhojnë lëndë për ushqim.

36. “Ambalazh" ose “material paketues” është çdo material, që shërben për paketimin e produkteve ushqimore, i cili mund ta mbulojë, tërësisht ose pjesërisht, këtë produkt. Ai e mbron produktin nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe vlerën ushqimore dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipe ambalazhesh, të përdorura në çastin që i ofrohet konsumatorit.

37. "Paraambalazhim" është vendosja, paraprakisht, e një produkti ushqimor në një ambalazh, për t'iu ofruar konsumatorit ose për përdorim kolektiv. Paraambalazhimi bëhet në mënyrë të tillë, që ambalazhi të mbulojë, tërësisht ose pjesërisht, ushqimin, por, në çdo rast, përmbajtja nuk mund të ndryshojë pa hapur apo ndryshuar ambalazhin.

KREU II
PARIME TË PËRGJITHSHME TË ANALIZËS SË RISKUT DHE MBROJTJES SË INTERESAVE TË KONSUMATORIT

Neni 4
Vlerësimi i riskut

1. Vlerësimi i riskut bazohet në vlefshmërinë e të dhënave shkencore dhe të vendimeve të marra në mënyrë të pavarur, objektive dhe transparente.

2. Vlerësimi i riskut kryhet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (më poshtë AKU).

Neni 5
Komunikimi i riskut

Komunikimi i riskut bëhet nga AKU-ja, për t’i siguruar një informacion të shpejtë, në kohë, objektiv dhe të kuptueshëm, për ushqimin, dëmtuesit dhe risqet:

a) Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

b) Ministrisë së Shëndetësisë;

c) operatorëve të biznesit të ushqimit për njerëz dhe kafshë;

ç) konsumatorëve;

d) institucioneve të tjera përgjegjëse;

dh) grupeve të interesit;

e) pushtetit vendor.

Neni 6
Menaxhimi i riskut

1. Menaxhimi i riskut siguron që masat parandaluese dhe ato të kontrollit, të marra për të parandaluar, zvogëluar ose eliminuar rreziqet për shëndetin e njerëzve, të lidhura me konsumimin e ushqimeve, të bazohen në rezultatet e vlerësimit të riskut.

2. Menaxhimi i riskut kryhet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 7

Parime parandaluese

1. Në rrethana të veçanta, kur nga vlerësimi i të gjithë informacionit në dispozicion, identifikohet mundësia e një efekti të dëmshëm të një ushqimi për shëndetin e njerëzve, për të cilin ekziston pasiguria shkencore, AKU-ja dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund të marrin masa të përkohshme për menaxhimin e riskut. Këto masa janë të nevojshme për të siguruar nivelin më të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve deri në çastin që sigurohet një informacion i bazuar shkencërisht, për një vlerësim të përgjithshëm të riskut.

2. Masat e marra, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, duhet të jenë të mjaftueshme, por jo të kufizojnë tregun më shumë sesa është e nevojshme, për të arritur nivel më të lartë në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, duke pasur parasysh lehtësitë teknike dhe ekonomike, si dhe gjendjen e krijuar.

3. AKU-ja dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të rishqyrtojnë, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në varësi të natyrës së riskut të identifikuar për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe të natyrës së informacionit të nevojshëm, masat e marra për të sqaruar pasiguritë shkencore.

Neni 8
Parimet e transparencës

1. AKU-ja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të konsumatorëve dhe/ose të grupeve të interesit, gjatë përgatitjes, vlerësimit dhe rishikimit të masave të menaxhimit të riskut, kryen këshillim publik, të hapur dhe transparent, me përjashtim të pamundësisë, për shembull, në raste urgjente.

2. Kur ka dyshime të justifikuara se ushqimi ose ushqimi për kafshë mund të paraqesë një rrezik për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve, në varësi të natyrës, seriozitetit dhe shkallës së këtij rreziku, AKU-ja merr masa për të informuar publikun për natyrën e rrezikut.

Në këtë rast, është i nevojshëm identifikimi i ushqimit ose ushqimit për kafshë, rreziku që ai mund të paraqesë, si dhe masat e marra, ose që mund të merren, për të parandaluar, zvogëluar ose zhdukur këtë rrezik.

Neni 9
Mbrojtja e interesave të konsumatorit

Ky ligj mbron interesat e konsumatorëve dhe siguron bazën për zgjedhjen prej tyre të informacionit të nevojshëm për konsumimin e ushqimeve. Ligji parandalon:

a) praktikat falsifikuese ose mashtruese;

b) cenimin e cilësisë së ushqimeve nga përdorimi i përbërësve të papërshtatshëm;

c) çdo praktikë tjetër që orienton në mënyrë të gabuar konsumatorin.

KREU III
KËRKESA TË PËRGJITHSHME TË SIGURISË USHQIMORE

Neni 10
Kërkesat e sigurisë ushqimore

1. Ushqimi është i sigurt kur nuk shkakton veprim të dëmshëm në shëndetin e njerëzve, kur prodhohet, përgatitet dhe konsumohet, sipas përdorimit të parashikuar.

2. Ushqimi quhet i pasigurt kur është:

a) i dëmshëm për shëndetin;

b) i papërshtatshëm për konsum njerëzor.

3. Ushqimi nuk nxirret në treg nëse është i pasigurt.

Neni 11
Përcaktimi i sigurisë ushqimore

1. Për të përcaktuar nëse një ushqim nuk është i sigurt duhen pasur parasysh:

a) kushtet normale të përdorimit të ushqimit nga konsumatori dhe çdo fazë e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes;

b) informacioni që i jepet konsumatorit, përfshirë informacionin e dhënë në etiketë ose informacione të tjera, të vlefshme për të, për parandalimin e efekteve të dëmshme, specifike për shëndetin nga një ushqim i caktuar ose nga një kategori ushqimesh.

2. Për të përcaktuar se një ushqim dëmton shëndetin duhet pasur parasysh:

a) jo vetëm mundësia e efektit të menjëhershëm, afatshkurtër ose afatgjatë të ushqimit në shëndetin e një personi që e konsumon atë, por edhe mundësia e efekteve në gjeneratat e ardhshme;

b) efektet toksike të mundshme grumbulluese;

c) ndjeshmëritë e veçanta shëndetësore të një kategorie të caktuar konsumatorësh, kur ushqimi është përcaktuar për këtë kategori.

3. Për të përcaktuar se një ushqim është i papërshtatshëm për konsum njerëzor, duhet që ushqimi të jetë i papranueshëm për t'u përdorur, sipas përcaktimit të tij, për konsum njerëzor, për arsye kontaminimi, të pranisë së lëndëve të huaja, të prishjes ose kalbëzimit.

4. Kur ushqimi, që përcaktohet i pasigurt, është pjesë e një pakoje, pjesë e një pjese të ngarkesës ose e ngarkesës së plotë të një ushqimi të së njëjtës kategori ose përshkrim, atëherë do të pranohet se i gjithë ushqimi i pakos, i pjesës së ngarkesës ose i ngarkesës së plotë është, gjithashtu, i pasigurt, vetëm nëse, pas kryerjes së analizave laboratorike, provohet e kundërta.

Neni 12
Vlerësimi i sigurisë ushqimore

1. Një ushqim është i dëmshëm për shëndetin e njerëzve nëse ai përmban:

a) mikroorganizma ose parazitë të dëmshëm për shëndetin e njerëzve, toksina bakteriale, mykotoksina, substanca histaminike ose të ngjashme me to dhe mikroorganizma apo parazitë në sasi më të mëdha se ato të lejuara nga standardet e miratuara;

b) toksina ose substanca natyrore toksike në sasi më të mëdha nga ato të lejuara;

c) mbetje të pesticideve, medikamenteve veterinare, metale dhe substanca të tjera, të dëmshme për shëndetin e njerëzve, në sasi më të mëdha se ato të lejuara;

ç) aditivë ushqimorë, të cilët nuk mund të përdoren në disa kategori ushqimesh ose kur sasia e aditivëve të pranishëm në ushqim është më e madhe se ajo e lejuar;

d) elemente radioaktive mbi normat e lejuara;

dh) materiale paketuese, që përmbajnë mikroorganizma ose substanca të tjera, që mund të ndikojnë në rritjen e përmbajtjes së substancave të dëmshme për shëndetin e njerëzve.

2. Një ushqim është i papërshtatshëm për konsum njerëzor nëse:

a) karakteristikat e tij ndryshohen për shkak të trajtimit fizik, kimik apo mikrobiologjik;

b) përmban substanca ose lëndë të para, të cilat nuk janë verifikuar dhe vlerësuar nga ana toksikologjike dhe nuk janë të sigurta për konsum publik;

c) përmban papastërti dhe përzierje, të cilat mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njerëzve.

Neni 13
Masat kufizuese

Masat kufizuese për nxjerrjen në treg të ushqimeve ose ushqimeve për kafshë, si dhe heqjen e tyre nga tregu, nëse ka dyshime të argumentuara shkencërisht se ushqimi ose ushqimi për kafshë është i pasigurt, përcaktohen, për çdo rast, me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

KREU IV
IMPORTI DHE EKSPORTI I USHQIMEVE

Neni 14
Importi

1. Ushqimi i importuar në Republikën e Shqipërisë nxirret në treg kur plotëson kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

2. Në rastin e marrëveshjeve të veçanta ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendit eksportues, ushqimi i importuar në Republikën e Shqipërisë nxirret në treg kur plotëson kërkesat e përcaktuara në këto marrëveshje.

Neni 15
Eksporti

1. Ushqimi i eksportuar nga Republika e Shqipërisë për nxjerrjen në treg në vendin ku eksportohet ose rieksportohet, duhet të plotësojë kërkesat e legjislacionit shqiptar për ushqimin, si dhe ato të vendit importues.

2. Në rastin e marrëveshjeve të veçanta ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendit importues, ushqimi i eksportuar nga Republika e Shqipërisë duhet të plotësojë kërkesat e përcaktuara në këto marrëveshje.

Neni 16
Mbikëqyrja e sigurisë së ushqimeve të importit

1. Kontrolli i përputhshmërisë së dokumentacionit shoqërues, sipas nenit 18 të këtij ligji, të ngarkesave të ushqimeve me origjinë shtazore të importuara me kërkesat e legjislacionit shqiptar kryhet në pikat e inspektimit kufitar nga inspektorët veterinarë të sigurisë ushqimore të kufirit. Kur vërehen mangësi në dokumentacion, malli bllokohet.

2. Kontrolli i sigurisë së ushqimeve të importuara kryhet në pikat e inspektimit kufitar. Gjatë kontrolleve merren mostra për analizim. Kontrollet, marrja e mostrave dhe analizimi i tyre bëhen sipas kritereve të hartuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

3. Pikat e inspektimit kufitar për ushqimet përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 17
Kontrolli në doganë i ushqimeve të importuara

1. Autoritetet doganore kryejnë procedurat doganore për ngarkesat ushqimore, pasi inspektorët e ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, në pikat e inspektimit kufitar, kanë dhënë miratimin.

2. Ngarkesa e ushqimeve, për të cilën ka dyshime, duhet të mbahet në ruajtje, brenda standardeve të lejuara, në magazinat doganore derisa të kryhen procedura e përcaktimit të sigurisë së tyre dhe procedura doganore.

3. Inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë, në pikat e inspektimit kufitar, për të verifikuar sigurinë e ushqimit të importuar, ka të drejtë të marrë mostra pa pagesë dhe t'i dërgojë ato në laboratorët e autorizuar për kryerjen e analizave, në bazë të planit të hartuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe të miratuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Rregullat e marrjes së mostrave përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe për kryerjen e analizave laboratorike përballohen nga importuesi. Tarifat përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit të Financave.

Neni 18
Certifikatat e importit

1. Ngarkesa e ushqimit të importuar shoqërohet me certifikatë, në përputhje me kërkesat ndërkombëtare, për sigurinë e ushqimit që importohet.

2. Për ushqimin që importohet, certifikatat e sigurisë së ngarkesave mund të njihen në mbështetje të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, të lëshuara nga autoriteti kompetent i vendit eksportues.

3. Në rast se nuk ka marrëveshje, sipas pikës 2 të këtij neni, njohja e certifikatave dhe dokumenteve të tjera kryhet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me propozimin e Autoriteti Kombëtar të Ushqimit.

4. Certifikatat dhe dokumentet e tjera të sigurisë duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e vendit prej nga ato vijnë.

KREU V
MIRATIMI DHE REGJISTRIMI I STABILIMENTEVE

Neni 19
Aplikimi, miratimi dhe regjistrimi

1. Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Drejtoritë rajonale të AKU-së në qarqe, pas verifikimit të dokumentacionit për regjistrim dhe plotësimit të kërkesave të këtij ligji nga stabilimenti aplikues, dërgojnë me shkrim në AKU kërkesën për regjistrimin e stabilimentit. AKU-ja ia dërgon këtë informacion Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon AKU-së listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e AKU-së, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të AKU-së.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga AKU-ja. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e

ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 20

Ndalimi i veprimtarisë së operatorëve të biznesit ushqimor

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me urdhër, mund të ndalojë, përkohësisht dhe përfundimisht, veprimtarinë e stabilimenteve, të lejuara sipas nenit 19 të këtij ligji, në rastet kur:

a) gjatë kontrolleve të ushtruara vihet re se stabilimenti nuk plotëson dispozitat e këtij ligji;

b) një procedurë e tillë është e rëndësishme dhe efektive për të garantuar sigurinë e ushqimeve.

Neni 21

Tarifat për procedurën e miratimit dhe të regjistrimit të stabilimenteve

1. Tarifat e regjistrimit e të miratimit të stabilimenteve dhe mënyra e shpërndarjes së tyre, sipas nenit 19 të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit dhe të Ministrit të Financave.

2. Tarifa për miratimin dhe regjistrimin e stabilimenteve përballohet nga aplikuesi.

KREU VI

PËRGJEGJËSITË E OPERATORËVE TË BIZNESIT USHQIMOR

Neni 22

Përgjegjësia për higjienën dhe sigurinë e ushqimeve

Operatorët e biznesit ushqimor mbajnë përgjegjësi për çdo dëmtim të shëndetit të njerëzve, të shkaktuar nga konsumi i ushqimit të rezultuar i pasigurt, në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe shpërndarjes.

Neni 23

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës së ushqimeve

1. Operatorët e biznesit ushqimor të prodhimit primar duhet të sigurojnë zbatimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës së ushqimeve. Këto kushte përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Operatorët e biznesit ushqimor, në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes së ushqimit, sigurojnë zbatimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës së ushqimeve, të cilat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Operatorët e biznesit ushqimor në tregun me shumicë duhet të zbatojnë kërkesat higjienike të veçanta, të cilat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

4. Operatorët e biznesit ushqimor që përgatisin, përpunojnë, trajtojnë dhe ruajnë në frigorifer ushqimin, në mjedise të tregtisë me pakicë, duhet të sigurojnë zbatimin sistematik të kërkesave higjienike të veçanta, të cilat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 24

Përgjegjësitë për ushqimet që nuk plotësojnë kërkesat

1. Nëse një operator i biznesit ushqimor vlerëson se një ushqim, të cilin ai e ka importuar,

prodhuar, përpunuar, shpërndarë apo nxjerrë në treg, nuk është në përputhje me kërkesat e sigurisë ushqimore apo dëmton shëndetin e njerëzve, ai menjëherë fillon procedurat për heqjen e ushqimit në fjalë nga tregu dhe vë në dijeni AKU-në dhe Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Kur ushqimi është blerë nga konsumatori, operatori duhet të njoftojë, në mënyrë efektive dhe të përshtatshme, konsumatorin për arsyet e heqjes nga tregu të ushqimit dhe, nëse është e nevojshme, i kërkon kthimin e ushqimit të blerë, kur masat e tjera nuk janë të mjaftueshme, për një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit.

3. Operatori i biznesit ushqimor, përgjegjës për veprimtarinë e shitjes me pakicë ose të shpërndarjes, veprimtaria e të cilit nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në paketimin, etiketimin, sigurimin dhe integritetin e ushqimit, fillon, sapo merr njoftim apo vendimin përkatës, procedurën e heqjes nga tregu të ushqimit, që nuk plotëson kërkesat e sigurisë ushqimore.

4. Operatori i biznesit ushqimor duhet t'u japë AKU-së dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë e ushqimit.

5. Operatori i biznesit ushqimor duhet të bashkëpunojë dhe nuk duhet të ndalojë asnjë person tjetër për të bashkëpunuar me AKU-në dhe Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në marrjen e masave për reduktimin e riskut të ardhur nga ushqimet, me të cilat ata furnizojnë ose kanë furnizuar tregun.

Neni 25

Kërkesat për gjurmueshmërinë e ushqimeve

1. Gjurmueshmëria përcaktohet në të gjitha nivelet e prodhimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes së ushqimit, të lëndëve të para, me origjinë bimore ose shtazore, kafshët, që prodhojnë ushqim ose kafshët e përdorura në prodhimin e ushqimeve, përfshirë gjurmimin e çdo substance tjetër, të përcaktuar për të bashkëvepruar ose që ka bashkëvepruar me ushqimin.

2. Operatorët e biznesit ushqimor krijojnë një sistem për mbajtjen e të dhënave, të quajtur bazë të dhënash dhe garantojnë procedurat, të cilat mundësojnë identifikimin e tyre në çdo çast. Nëpërmjet këtyre të dhënave bëhet identifikimi i çdo personi fizik apo juridik, që i ka furnizuar ata me ushqime, me kafshë që prodhojnë ushqime, kafshë të përdorura për prodhimin e ushqimeve ose me çdo substancë tjetër, të përcaktuar për prodhimin apo që pritet të përdoret për prodhimin e ushqimit.

3. Operatorët e biznesit ushqimor e ruajnë informacionin e përmendur në pikën 2 të këtij neni për tre vjet dhe ia japin këtë informacion AKU-së dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me kërkesë të tyre.

4. Ushqimi i nxjerrë në treg ose që mund të nxirret në treg duhet të etiketohet dhe të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë. Kërkesat për gjurmueshmërinë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 26

Kërkesat për sistemin e vetëkontrollit

1. Operatori i biznesit ushqimor, me përjashtim të prodhimit primar, siguron kontroll të rregullt të kushteve higjienike të prodhimit, në çdo objekt, nëpërmjet zbatimit të procedurave parandaluese të sistemit të vetëkontrollit, sipas parimeve të sistemit të analizës së riskut dhe pikave kritike të kontrollit (më poshtë HACCP), duke:

a) identifikuar të gjithë dëmtuesit, të cilët mund të parandalohen, eliminohen ose reduktohen në një nivel të pranueshëm;

b) identifikuar pikat kritike të kontrollit;

c) përcaktuar limitet kritike në pikat kritike të kontrollit;

ç) përcaktuar procedurat efektive të monitorimit sistematik të pikave kritike të kontrollit;

d) përcaktuar veprimet korrigjuese, kur sistemi i monitorimit paralajmëron se pika kritike e kontrollit nuk është nën kontroll;

dh) përcaktuar nëse procedurat e verifikimit të masave, të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "d" të kësaj pike, janë efektive;

e) mbajtur dokumente dhe regjistra të përshtatshëm për identifikimin e zbatimit efektiv të masave të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh” të kësaj pike.

2. Operatori i biznesit ushqimor, në nivelin primar të prodhimit, përcakton dhe vë në zbatim kontrollin e rregullt të kushteve higjienike të prodhimit në çdo objekt që ka nën kontroll, nëpërmjet zbatimit të procedurave parandaluese të vetëkontrollit, sipas modelit të praktikave të mira të prodhimit.

3. Verifikimi fillestar i përshtatshmërisë së planeve të HACCP-së, për objektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kryhet nga AKU-ja.

4. Në rast se rezultatet e vetëkontrollit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, tregojnë ekzistencën e rreziqeve shëndetësore për njerëzit, atëherë vlerësohet se ushqimi nuk plotëson kërkesat e sigurisë ushqimore dhe operatori i biznesit ushqimor merr masat e përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji.

5. Kushtet për zbatimin e sistemit të vetëkontrollit në objektet e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

6. Operatori i biznesit ushqimor mban dokumentacion për zbatimin e sistemit të vetëkontrollit dhe e përditëson atë. Me kërkesën e AKU-së dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, operatori jep të dhëna për përputhjen e veprimtarisë së tij me kërkesat e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni.

7. Përjashtime nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhen për operatorë të veçantë të biznesit ushqimor, veçanërisht për operatorë të vegjël, kategori të veçanta operatorësh, në shitjen me pakicë dhe të prodhimit të produkteve tradicionale, me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëse garantohet arritja e një niveli të pranueshëm higjienik në zbatimin e sistemit të procedurave të vetëkontrollit, sipas praktikave të mira të prodhimit.

KREU VII
USHQIMET E REJA

Neni 27
Kategoritë e ushqimeve të reja

1. Vlerësohen pjesë e ushqimeve të reja kategoritë e mëposhtme:

a) ushqimi dhe përbërësit ushqimorë, të cilët përmbajnë ose përbëhen nga organizma të modifikuar gjenetikisht (më poshtë OMGJ);

b) ushqimi dhe përbërësit ushqimorë, duke përjashtuar ushqimet shtesë (aromatizuesit dhe enzimat) të prodhuara dhe që nuk përmbajnë OMGJ;

c) ushqimi dhe përbërësit ushqimorë me strukturë molekulare parësore, të re ose të modifikuar qëllimisht;

ç) ushqimi dhe përbërësit ushqimorë, që përbëhen nga mikroorganizma, kërpudha, alga ose që janë të izoluara prej tyre;

d) ushqimi dhe përbërësit ushqimorë, me origjinë bimore apo shtazore, materiale minerale, sintetike ose që janë të izoluara prej tyre, duke përjashtuar ushqimet dhe përbërësit ushqimorë, të cilët janë përftuar në mënyrë tradicionale riprodhimi dhe që, për një kohë të gjatë, është vërejtur se janë të sigurta për konsum.

dh) ushqimi dhe përbërësit ushqimorë, për të cilët është zbatuar një proces prodhimi jobashkëkohor, që shkakton ndryshime të rëndësishme në përbërjen, strukturën dhe përbërësit ushqimorë e që ndikon në vlerat ushqyese, në metabolizmin ose në nivelin e substancave të padëshiruara.

2. Vlerësohen pjesë të ushqimeve të reja, përveç atyre të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, edhe kategoritë e ushqimeve, që janë:

a) plotësisht ose pjesërisht me lëndë të para të reja;

b) me përbërje bazë të ndryshuar;

c) prodhuar me teknologji prodhimi, që ndryshon nga të mëparshmet.

3. Kategoritë e ushqimeve të reja, të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nuk duhet:

a) të dëmtojnë shëndetin e njerëzve;

b) të mashtrojnë konsumatorin;

c) të ndryshojnë nga ushqimet dhe përbërësit ushqimorë, që janë përcaktuar të zëvendësojnë në atë masë, që konsumimi normal i tyre të përbëjë disavantazh ushqimor për konsumatorin.

4. Dispozitat e këtij ligji dhe rregulloret e përmendura në pikën 5 të këtij neni zbatohen në kategoritë e ushqimeve të reja, të përcaktuara në shkronjat "a" e "b" të pikave 1 e 2 të këtij neni.

5. Rregulloret e veçanta të ushqimeve të reja përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 28

Nxjerrja në treg e ushqimeve të reja

1. Për nxjerrjen në treg të ushqimeve të reja në Republikën e Shqipërisë, aplikuesi duhet të marrë leje nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, pas dhënies së mendimit paraprak shkencor të AKU-së.

2. Kushtet dhe procedurat për dhënien e lejes, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 29

Regjistri për lejet e dhëna për nxjerrjen e ushqimeve të reja në treg

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mban regjistrin për lejet e dhëna për nxjerrjen e ushqimeve të reja në treg.

2. Përmbajtja, forma dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 30

Ndalimi i nxjerrjes së ushqimeve të reja në treg

1. Nëse ka ndonjë mospërputhje shkencore për efektin e dëmshëm të ushqimeve të reja në shëndetin e njerëzve, veçanërisht të ushqimit dhe të përbërësve të ushqimit, të cilat përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht ose që përbëhen nga ta, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ndalon përkohësisht nxjerrjen e një ushqimi të tillë në treg, për parandalimin ose zvogëlimin e mundësisë së ndikimeve negative në shëndetin e njerëzve.

2. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ndalon nxjerrjen e ushqimeve të reja në treg, veçanërisht të ushqimit dhe të përbërësve ushqimorë, të cilët përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht ose që përbëhen nga ta, nëse, bazuar në vlerësimin e një rreziku shkencor, janë vlerësuar të dëmshme për shëndetin e njerëzve.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ndalon, përkohësisht ose përgjithmonë, importin e ushqimeve të reja, që përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht, kur nuk ka informacion shkencor dhe njohuri për pasojat negative të mundshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Neni 31

Asgjësimi i ushqimeve të reja të pasigurta

Ushqimet e reja, veçanërisht ushqimet dhe përbërësit ushqimorë, të cilët përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht ose që përbëhen nga ta, që nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë, të parashikuara nga ky ligj, asgjësohen. Procedurat e asgjësimit të ushqimeve të reja përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

KREU VIII

PËRCAKTIMI I ORIGJINËS DHE I TREGUESVE GJEOGRAFIKË TË USHQIMEVE

Neni 32

Përcaktimi i origjinës dhe i treguesve gjeografikë të ushqimeve

1. Përcaktimi i origjinës së ushqimit përmban emrin e rajonit, vendin specifik ose, në raste të veçanta, emrin e vendit të përdorur, për të përshkruar ushqimin:

a) i cili vjen nga ky rajon, vend specifik ose nga vendi i përdorimit;

b) cilësia dhe karakteristikat e të cilit janë rrjedhojë e ndikimit të faktorëve natyrorë dhe njerëzorë të një mjedisi gjeografik specifik, si dhe prodhimi, përpunimi dhe përgatitja e tij kryhen në këtë mjedis gjeografik.

2. Tregues gjeografikë vlerësohen emri i rajonit, vendi specifik ose, në raste të veçanta, emri i vendit të përdorur për të përshkruar ushqimin, i cili:

a) vjen nga ky rajon, vend specifik ose nga vendi i përdorimit;

b) ka cilësi të veçanta, reputacion ose disa karakteristika të tjera, që janë atribute të origjinës gjeografike të tij dhe prodhimi, përpunimi e përgatitja e tij kryhen në këtë mjedis gjeografik.

3. Ushqimet me origjinë të përcaktuar, tregues gjeografikë të përcaktuar, si dhe metodat e kontrollit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

KREU IX

TREGUESI "PRODUKT USHQIMOR TRADICIONAL" I USHQIMIT

Neni 33

Treguesi "Produkt ushqimor tradicional" i ushqimit

1. Ushqimi pajiset me treguesin "Produkt ushqimor tradicional", nëse është prodhuar nëpërmjet përdorimit të materialeve të papërpunuara tradicionale, ka një përbërje tradicionale, është prodhuar ose përpunuar në mënyrë tradicionale dhe dallohet për karakteristika të veçanta nga ushqimet e së njëjtës kategori. Në etiketë shënohet "Produkt ushqimor tradicional".

2. Produktet ushqimore, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Prodhuesit e përpunuesit dhe shoqatat e prodhuesve dhe/ose të përpunuesve (më poshtë shoqatat) kanë të drejtë të aplikojnë për marrjen e treguesit "Produkt ushqimor tradicional", pavarësisht nga forma ligjore apo përbërja e shoqatës, e cila e prodhon ose e përpunon këtë ushqim. Aplikuesit duhet të paraqesin kërkesën dhe specifikimin e produktit ushqimor.

4. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit përcakton, me udhëzim, kushtet, procedurën për njohjen e karakterit të veçantë të ushqimit, përmbajtjen e specifikimit dhe emëron një komision për dhënien e treguesit "Produkt ushqimor tradicional". Përbërja dhe mënyra e funksionimit të këtij komisioni përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 34

Regjistri i produkteve me tregues "Produkt ushqimor tradicional"

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mban një regjistër të produkteve ushqimore, që i referohen treguesit "Produkt ushqimor tradicional".

2. Përmbajtja, forma dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 35

Regjistrimi dhe çregjistrimi i produkteve me treguesin "Produkt ushqimor tradicional"

1. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit miraton, me urdhër, vendimin e komisionit për regjistrimin në regjistër të ushqimit me tregues "Produkt ushqimor tradicional".

2. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me propozimin e komisionit, urdhëron me shkrim çregjistrimin nga regjistri të ushqimit me tregues "Produkt ushqimor tradicional", kur ai nuk plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 33 të këtij ligji.

KREU X
ETIKETIMI DHE PUBLIKIMI I USHQIMIT

Neni 36
Kërkesa të përgjithshme të etiketimit të ushqimit

1. Ushqimi, që nxirret në treg, pajiset me etiketën, ku shënohen:

a) emri i produktit;

b) lista e përbërësve;

c) sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve;

ç) sasia neto, në rastin e ushqimeve të paraambalazhuara;

d) data e jetëgjatësisë minimale ose, në rastin e ushqimeve që nga pikëpamja mikrobiologjike paraqesin rrezik, shënohet "të përdoret deri më...";

dh) çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit;

e) emri apo emërtimi i biznesit dhe adresa e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;

ë) vendi i origjinës;

f) udhëzimet e përdorimit, kur ushqimi nuk mund të përdoret pa të;

g) grada alkoolike për vëllim për pijet, që përmbajnë më shumë se 1,2 për qind të vëllimit alkool;

gj) përmbajtja ose përbërja e OMGJ-ve, si dhe OMGJ-të që përmban.

2. Etiketa duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, të jetë e dallueshme, e lexueshme dhe e kuptueshme.

3. Mënyra e etiketimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 37
Paraqitja dhe reklama e ushqimit

1. Paraqitja e ushqimit dhe e ushqimit për kafshë përfshin formën e tyre, pamjen e jashtme ose ambalazhimin, materialet paketuese të përdorura, mënyrën, sipas së cilës ato janë rregulluar dhe mjedisin ku janë paraqitur, si dhe informacionin e vlefshëm rreth tij me çdo mjet informimi.

2. Reklama e ushqimit ose e ushqimit për kafshë bëhet vetëm pasi AKU-ja jep të drejtën e prodhimit dhe të tregtimit të tyre.

3. Mënyra e paketimit, reklamës dhe paraqitjes së ushqimeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

KREU XI
KONTROLLI ZYRTAR I USHQIMEVE

Neni 38
Kontrolli zyrtar i ushqimeve

Kontrolli zyrtar i ushqimeve përfshin një ose më shumë nga veprimtaritë e mëposhtme:

a) inspektimin;

b) marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave;

c) kontrollin e etiketës dhe të dokumentacionit zyrtar;

ç) shqyrtimin e dokumentacionit për gjurmueshmërinë;

d) shqyrtimin e sistemit të vetëkontrollit.

Neni 39
Organet përkatëse të kontrollit

Kontrolli zyrtar i ushqimeve kryhet nga Inspektorati i Kontrollit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë dhe laboratorët e autorizuar të sigurisë ushqimore dhe të veterinarisë, në përbërje të AKU-së. Inspektorati i Kontrollit të Ushqimit e Ushqimit për Kafshë ka në përbërje të tij specialistë të fushës, të certifikuar nga AKU-ja.

Neni 40
Parimet e përgjithshme të kontrollit zyrtar të ushqimit

1. Kontrolli zyrtar i ushqimit kryhet:
a) rregullisht dhe në përputhje me përparësitë e përcaktuara në skemën e vlerësimit të riskut;
b) kur ka arsye për të besuar se kërkesat e këtij ligji nuk janë plotësuar.
2. Kontrolli kryhet duke përdorur mjete të përshtatshme dhe të kontrollueshme.
3. Kontrolli zyrtar mbulon të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes.
4. Kontrolli zyrtar, si rregull, kryhet pa paralajmërim.

Neni 41
Objekti i kontrollit zyrtar të ushqimeve

Kontrolli zyrtar i ushqimeve ka objekt:
1. Vendndodhjen, kushtet dhe gjendjen e stabilimentit, planimetrinë e prodhimit, zyrat, mjedisin, mjetet e transportit, të përdorura në biznesin ushqimor, veçanërisht kushtet e përcaktuara në nenet 19 e 20 të këtij ligji.
2. Inspektimin e gjendjes shëndetësore të personelit dhe të higjienës së objekteve, që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimin.
3. Lëndët e para, ujin, përbërësit, aditivët, shtesat teknologjike dhe substancat e tjera, të përdorura për përgatitjen dhe prodhimin e ushqimit.
4. Ushqimet gjysmë të gatshme.
5. Ushqimet e gatshme.
6. Pastrimin, substancat pastruese dhe të mirëmbajtjes që përdoren në proceset e prodhimit.
7. Proceset e përdorura për prodhimin ose përpunimin e ushqimeve.
8. Mënyrën e paketimit, materialet paketuese dhe ato në kontakt me ushqimin.
9. Etiketimin dhe dokumentet shoqëruese të ushqimeve.
10. Përcaktimin e origjinës, të treguesve gjeografikë të mbrojtur dhe treguesin “Produkt ushqimor tradicional”.
11. Proceset teknologjike që zbatohen në prodhimin dhe përgatitjen e ushqimeve.
12. Aditivët ushqimorë, materialet në kontakt me ushqimin, kontaminuesit ushqimorë, si dhe substancat pastruese përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 42
Marrja e mostrave për analizat laboratorike

1. Për qëllim të kontrollit zyrtar të ushqimeve merren mostra të materialeve të papërpunuara të përbërësve, shtesave teknologjike dhe të substancave të tjera, të përdorura për përgatitjen dhe prodhimin e ushqimeve, ushqimeve gjysmë të gatshme, ushqimeve të gatshme, materialeve në kontakt me ushqimet, përfshirë substancat që përdoren për pastrimin dhe mirëmbajtjen në biznesin ushqimor.
2. Operatorët e biznesit ushqimor lejojnë marrjen e sasive të nevojshme të mostrave pa pagesë për kryerjen e analizave, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni.
3. Procedurat e marrjes së mostrave përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 43
Masat e përgjithshme të administrimit të kontrollit zyrtar të ushqimeve

1. Inspektori i kontrolli të ushqimit dhe i ushqimit për kafshë ka të drejtë të hyjë, të kontrollojë dhe të fotografojë shkeljet e konstatuara në stabilimentin ushqimor ose në çdo ndërtesë tjetër ku ushqimi prodhohet, përpunohet dhe shpërndahet, me përjashtim të vendeve të banimit.

2. Kur inspektori i kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, gjatë kontrollit zyrtar, zbulon ose ka arsye për të dyshuar për një shkelje të dispozitave të këtij ligji, merr masat e nevojshme për t'u siguruar që shkelja do të korrigjohet nga operatori i biznesit ushqimor.

3. Pronari, poseduesi, personi përgjegjës, i punësuari në stabiliment, që ndodhen në stabiliment në çastin e kontrollit, duhet të japin informacionin dhe ndihmesën e kërkuar nga inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

4. Inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë nuk pengohet në kryerjen e detyrave të tij.

5. Personave të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni nuk u lejohet të marrin asnjë masë të përcaktuar në këtë ligj, për korrigjimin e parregullsive, pa miratim me shkrim të inspektorit.

6. Inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë kryen kontroll zyrtar, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj dhe në ligje të tjera të veçanta në fushën e ushqimit.

7. Detyrat, përgjegjësitë e Inspektoratit të Kontrollit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë, programi vjetor i inspektimeve dhe raportimi përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

KREU XII
LABORATORËT E AUTORIZUAR TË KONTROLLIT DHE LABORATORËT E REFERENCËS

Neni 44
Laboratorët e autorizuar të kontrollit

1. Analizat laboratorike të mostrave, sipas neneve 17 e 40 të këtij ligji, të marra për kryerjen e kontrollit zyrtar të ushqimit, bëhen në laboratorët e autorizuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Inspektori i kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë i dërgon mostrat e marra në një laborator të autorizuar kontrolli për kryerjen e kontrollit zyrtar.

3. Tarifa e analizave të kryera, për ushqimet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë, mbulohet nga AKU-ja. Kur ushqimi nuk përmbush kërkesat e detyrueshme, të bazuara në këtë ligj, si edhe/ose informacionin e specifikuar mbi etiketë, tarifat paguhen nga operatori i biznesit ushqimor, që e prodhon dhe/ose e nxjerr në treg ushqimin.

4. Lista e laboratorëve të autorizuar të kontrollit, ku përcaktohet tipi i laboratorit dhe analizat, që janë të autorizuar të kryejnë, miratohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe botohet në Fletoren Zyrtare një herë në vit.

Neni 45
Veprimtaritë e laboratorëve të autorizuar të kontrollit

1. Laboratorët e autorizuar të kontrollit kryejnë:

a) veprimtaritë bazë;

b) veprimtaritë e specializuara;

c) veprimtaritë e specializuara për të lëshuar certifikata ndërkombëtare.

2. Laboratorët e autorizuar të kontrollit, për të kryer veprimtari bazë, duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Laboratorët e autorizuar të kontrollit, për kryerjen e veprimtarive të specializuara, duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara në praktikat e mira laboratorike.

4. Laboratorët e autorizuar të kontrollit, që kryejnë veprimtari të specializuara, për të lëshuar certifikata ndërkombëtare, duhet të akreditohen nga një institucion i pavarur.

Akreditimi, vlerësimi dhe autorizimi i laboratorëve të analizave mund të bëhen për analiza të veçanta ose për një grup analizash dhe për lloje të veçanta ushqimesh.

5. Me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund të

përcaktohen kushte të veçanta, që duhet të përmbushin laboratorët e analizave, të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni.

6. Procedurat e kategorizimit, vlerësimit dhe autorizimit të laboratorëve të kontrollit, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

7. Laboratorët e autorizuar të kontrollit u nënshtrohen programeve të përshtatshme të testimit.

Neni 46

Laboratorët e referencës

1. Laboratorët e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe të Veterinarisë janë laboratorë reference, për çdo analizë të kryer, për kontrollin zyrtar të sigurisë së ushqimeve. Një laborator mund të jetë laborator reference për një ose me shumë analiza.

2. Laboratorët e referencës duhet të akreditohen nga një institucion i pavarur.

3. Laboratorët e referencës duhet:

a) të bëjnë vlerësimin e laboratorëve të autorizuar nëse janë të aftë për kryerjen e analizave, të kontrolleve zyrtare, vlerësim i cili shërben për pajisjen e tyre me autorizim nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

b) të bashkërendojnë punën dhe të ofrojnë mbështetje, përfshirë trajnime dhe shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe metodat e analizave që kryejnë;

c) të organizojnë teste paralele të mostrave të standardizuara dhe të marrin pjesë në to në nivel kombëtar e ndërkombëtar për monitorimin e kualifikimit të laboratorëve të autorizuar të kontrollit;

ç) të garantojnë se laboratorët e autorizuar përdorin sistemin e tyre të brendshëm të menaxhimit të cilësisë.

4. Lista e laboratorëve të referencës, ku specifikohen analizat, që ata janë të autorizuar të kryejnë, botohet në Fletoren Zyrtare një herë në vit.

KREU XIII

MENAXHIMI I KRIZAVE DHE I EMERGJENCAVE

Neni 47

Masat urgjente për garantimin e sigurisë ushqimore

1. Kur vërehet se ushqimi paraqet një rrezik serioz për shëndetin e njerëzve ose për mjedisin dhe se një rrezik i tillë nuk mund të eliminohet, me propozimin e AKU-së, në varësi të shkallës së vështirësisë së gjendjes, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit urdhëron marrjen e masave, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Nëse ushqimi është prodhuar në vend, merren këto masa:

a) ndalimi i përkohshëm i hedhjes në treg ose i përdorimit të ushqimit;

b) përcaktimi i kushteve të veçanta për ushqime specifike;

c) eliminimi i ushqimeve, pa shkaktuar dëme;

ç) masa të tjera të përkohshme dhe të përshtatshme.

3. Nëse ushqimi është i importuar, merren këto masa:

a) ndalimi i përkohshëm i importit të ushqimit nga vendet eksportuese ose nga pjesë të vendit eksportues ose të vendeve tranzit;

b) përcaktimi i masave të veçanta për ushqime specifike nga vendet eksportuese, pjesë të vendeve eksportuese ose nga vendet tranzit;

c) eliminimi i ushqimeve pa shkaktuar dëme;

ç) masa të tjera të përkohshme dhe të përshtatshme.

Neni 48

Plani i përgjithshëm për menaxhimin e krizave

1. AKU-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, harton një plan të përgjithshëm për trajtimin e krizave në fushën e sigurisë ushqimore.

2. Ky plan miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përcakton:

a) llojet e riskut, me origjinë ushqimore, të cilat mund të rrezikojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, shëndetin e njerëzve e që nuk mund të eliminohen apo reduktohen deri në një nivel të pranueshëm, nëpërmjet zbatimit të dispozitave, të parashikuara në këtë ligj;

b) procedurat praktike thelbësore për trajtimin e një krize;

c) ngritjen e një njësie për menaxhimin e krizave pranë AKU-së.

Kjo njësi përcakton strategjinë e komunikimit në rastet e krizave ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe AKU-së, institucioneve të tjera përgjegjëse, konsumatorit dhe operatorëve të biznesit të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë.

KREU XIV
USHQIMI PËR KAFSHËT

Neni 49
Kërkesat e përgjithshme të sigurisë së ushqimeve për kafshë

1. Ushqimi për kafshë nuk nxirret në treg ose nuk përdoret si ushqim për kafshë që prodhojnë ushqime, nëse nuk është i sigurt.

2. Ushqimi për kafshë nuk është i sigurt për t'u përdorur nëse:

a) ka një efekt të dëmshëm në shëndetin e njerëzve ose të kafshëve;

b) produktet e prodhuara nga kafshët nuk janë të sigurta për konsum njerëzor.

3. Kur një ushqim për kafshë, i identifikuar se nuk plotëson kërkesat e sigurisë ushqimore për kafshë, është pjesë e një pakoje, pjesë e një pjese të ngarkesës ose e ngarkesës së plotë të një ushqimi të së njëjtës kategori ose përshkrimi, atëherë i gjithë ky ushqim nuk është i sigurt, vetëm nëse, pas kryerjes së analizave laboratorike, provohet e kundërta.

Neni 50
Përcaktimi i sigurisë së ushqimeve për kafshë

1. Nëse ka arsye të dyshohet se ushqimi për kafshë nuk është i sigurt, me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me propozimin e AKU-së, merren masa për kufizimin e tregtimit të këtij ushqimi ose heqjen e tij nga tregu.

2. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nxjerr udhëzime, ku përcaktohen:

a) kërkesat për sigurinë e ushqimit për kafshë;

b) kushtet higjienike, kur veprohet me ushqimin për kafshë;

c) zbatimi i sistemit të vetëkontrollit në operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë, për garantimin e sigurisë së ushqimit të kafshëve, që nxirret në treg;

ç) kërkesat për punonjësit teknikë, hapësirat dhe pajisjet e laboratorëve për kryerjen e analizave të ushqimit për kafshë;

d) ndalimi ose kufizimi i përdorimit të lëndëve të para të veçanta në prodhimin e ushqimit për kafshë, të cilat rrjedhin nga burime specifike, kullotat që lidhen me llojin e kafshës dhe me procesin e përpunimit;

dh) kushte të tjera, që lidhen me ushqimin për kafshë dhe që vlerësohen se janë thelbësore për të garantuar se ushqimi për kafshë i përmbush kërkesat e sigurisë.

Neni 51
Importi dhe eksporti i ushqimit për kafshë

1. Nenet 14 e 15 të këtij ligji zbatohen edhe për importin dhe për eksportin e ushqimit për kafshë në Republikën e Shqipërisë.

2. Importuesi i ushqimit për kafshë i paraqet inspektorit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë në pikat e inspektimit kufitar një kërkesë për kontrollin e kontingjentit të ushqimit për kafshë që ai ka importuar, për të përcaktuar sigurinë e këtij ushqimi.

3. Autoriteti doganor kryen procedurën doganore për kontingjentin e ushqimit për kafshë, pasi inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë i pikës së inspektimit kufitar përcakton sigurinë e kontingjentit dhe, me vendim, miraton importin.

4. Autoriteti doganor është i detyruar që, brenda përgjegjësive dhe detyrave të tij, t'i verë në dispozicion inspektorit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë të pikës së kalimit kufitar të gjithë dokumentacionin dhe ta lejojë të bëjë kontrollin e nevojshëm, për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave të sigurisë së ushqimit për kafshë.

5. Kur për ngarkesën e ushqimit për kafshë ka dyshime, deri në plotësimin e procedurës së përcaktimit të sigurisë dhe përpara plotësimit të procedurës doganore, ngarkesa mbahet në ruajtje në magazinat doganore.

6. Inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë i pikës së kalimit kufitar, për verifikimin e sigurisë së ushqimit për kafshë të importuar, ka të drejtë të marrë mostra dhe t'i analizojë ato në laboratorët e autorizuar.

7. Shpenzimet për analizimin e kontingjentit, lëshimin e formularit zyrtar të vendimit, sipas pikës 3 të këtij neni dhe shpenzimet e kontrollit laboratorik mbulohen nga importuesi.

Neni 52

Regjistrimi në regjistrin e stabilimenteve

Për procesin e regjistrimit në regjistrin e stabilimenteve, ku përpunohet ose magazinohet ushqimi për kafshë, zbatohen dispozitat e legjislacionit për veterinarinë.

Neni 53

Detyrat dhe përgjegjësitë e operatorëve të biznesit të ushqimit për kafshë

Detyrat dhe përgjegjësitë e operatorëve të biznesit të ushqimit për kafshë duhet të jenë në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në kreun VI të këtij ligji për:

a) higjienën dhe sigurinë e ushqimit për kafshë;

b) procedurat e nevojshme që duhet të ndërmerren, nëse ushqimi për kafshë nuk përmbush kërkesat e sigurisë;

c) futjen e sistemit të vetëkontrollit në stabilimentet e biznesit të ushqimit për kafshë;

ç) futjen e një sistemi, që mundëson gjurmueshmërinë e ushqimit për kafshë.

Neni 54

Hedhja në treg e ushqimit për kafshë, që ka në përbërje ose në përmbajtje OMGJ

1. Aplikuesi, për nxjerrjen për herë të parë në treg të ushqimit për kafshë dhe të përbërësve të këtyre ushqimeve, të cilat kanë në përbërje ose përmbajnë OMGJ, duhet të pajiset me leje nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në mbështetje të mendimit shkencor të dhënë më parë nga AKU-ja.

2. Kushtet dhe procedurat për dhënien e lejes, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

3. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mban një regjistër për lejet e dhëna për nxjerrjen në treg të ushqimit për kafshë dhe të përbërësve të tyre, të cilët kanë në përbërje ose përmbajnë OMGJ.

4. Përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të përmendur në pikën 3 të këtij neni përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, mund të ndalojë, përkohësisht ose përgjithmonë, importin e ushqimit për kafshë, që përmban organizma të modifikuar gjenetikisht, nëse nuk ka informacion shkencor dhe njohuri të mjaftueshme për ndikimin e mundshëm të pasojave negative në jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Neni 55

Asgjësimi i ushqimeve për kafshë që përmbajnë OMGJ

Ushqimi për kafshë dhe përbërësit e tij, që kanë në përbërje ose përmbajnë OMGJ, që nuk përputhen me kërkesat e sigurisë, të përcaktuara nga ky ligj, duhen asgjësuar, sipas legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 56
Etiketimi i ushqimit për kafshë

1. Etiketimi i ushqimit për kafshë bëhet sipas kërkesave të përgjithshme, të përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji dhe në ligjin nr.8411, datë 1.10.1998 “Për ushqimet e blegtorisë”.

2. Mënyra e etiketimit të ushqimit për kafshë, përfshirë dhe ato që kanë në përbërje ose përmbajnë OMGJ, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 57
Kontrolli zyrtar i ushqimit për kafshë

1. Kontrolli zyrtar i ushqimit për kafshë kryhet në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

2. Kontrolli zyrtar i ushqimit për kafshë, përfshirë edhe aditivët e ushqimit për kafshë, kryhet nga Inspektorati i Kontrollit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë dhe përfshin të gjitha nivelet e prodhimit, të përpunimit e të shpërndarjes.

3. Dispozitat e neneve 40, 41 e 43 të këtij ligji zbatohen edhe për kontrollin zyrtar të ushqimit për kafshë.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të Kontrollit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë, si dhe programi vjetor i inspektimeve e mënyra e raportimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 58
Marrja e mostrave për analizimin laboratorik të ushqimit për kafshë

1. Për kryerjen e kontrollit zyrtar të ushqimit për kafshë merren mostra të lëndëve të para, të përbërësve, shtesave teknologjike dhe substancave të tjera, të përdorura në përgatitjen dhe prodhimin e ushqimit për kafshë, të materialeve që bien në kontakt të drejtpërdrejtë me këtë ushqim, përfshirë substancat pastruese dhe materialet e mirëmbajtjes, të cilat përdoren në biznesin e ushqimit për kafshë.

2. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë janë të detyruar të lejojnë marrjen e sasive të nevojshme pa pagesë të mostrave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për qëllime analizash laboratorike.

Neni 59
Laboratorët e autorizuar të kontrollit dhe të referencës

1. Analizat laboratorike të mostrave, të marra për kryerjen e kontrollit zyrtar të ushqimit për kafshë, sipas nenit 58 të këtij ligji, bëhen nga laboratorë të autorizuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Inspektori i kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë është autoriteti zyrtar për marrjen dhe dërgimin e mostrave në një laborator të autorizuar kontrolli.

3. Tarifa e analizave të kryera për ushqimet për kafshë, të prodhuara në Republikën e Shqipërisë, mbulohet nga AKU-ja dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe, nëse ushqimi për kafshë nuk përmbush kërkesat e detyrueshme, të bazuara në këtë ligj dhe/ose në informacionin e specifikuar mbi etiketë, tarifat mbulohen nga operatori i biznesit të ushqimit për kafshë, që e prodhon dhe/ose e nxjerr në treg këtë ushqim.

4. Lista e laboratorëve të autorizuar të kontrollit, ku përcaktohen tipi i laboratorit dhe analizat, që ato janë të autorizuar të kryejnë, miratohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe botohet në Fletoren Zyrtare një herë në vit.

5. Për laboratorët e autorizuar të kontrollit, sipas pikës 1 të këtij neni, zbatohet edhe neni 45 “Veprimtaritë e laboratorëve të autorizuar të kontrollit” të këtij ligji.

6. Laboratorët e Institutit të Sigurisë së Ushqimeve dhe të Veterinarisë janë laboratorë reference, për çdo analizë të kryer, për qëllim të kontrollit zyrtar të sigurisë së ushqimeve për kafshë.

7. Laboratorët e referencës duhet të akreditohen nga një institucion i pavarur.

8. Trajnojnë dhe certifikojnë inspektorët e kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

9. Laboratorët e referencës duhet:

a) të bëjnë vlerësimin e laboratorëve të autorizuar nëse janë të aftë për kryerjen e analizave, të kontrolleve zyrtare, vlerësim i cili shërben për pajisjen me autorizim nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

b) të bashkërendojnë punën dhe të ofrojnë mbështetje, përfshirë trajnime dhe shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe metodat e analizave që kryejnë;

c) të organizojnë teste paralele të mostrave të standardizuara dhe të marrin pjesë në to në nivel kombëtar e ndërkombëtar, për monitorimin e kualifikimit të laboratorëve të autorizuar të kontrollit;

ç) të garantojnë se laboratorët e autorizuar përdorin sistemin e tyre të brendshëm të menaxhimit të cilësisë.

10. Lista e laboratorëve të referencës, ku specifikohen analizat, që ata janë të autorizuar të kryejnë, miratohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe botohet në Fletoren Zyrtare një herë në vit.

Neni 60

Trajtimi i krizave dhe i emergjencave

Masat urgjente për garantimin e sigurisë ushqimore dhe plani i përgjithshëm për menaxhimin e krizave, të përcaktuara në nenet 47 e 48 të këtij ligji, zbatohen edhe për trajtimin e krizave dhe të emergjencave për garantimin e sigurisë së ushqimit për kafshë.

KREU XV

AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Neni 61

Parime të përgjithshme

1. Në varësi të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit krijohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

2. AKU-ja është person juridik, publik, me seli në Tiranë dhe drejtori rajonale në qarqe.

3. AKU-ja kryen veprimtari inspektuese, teknike dhe shkencore, në përputhje me këtë ligj dhe ligjet e tjera specifike, për sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë, për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe për mbrojtjen e bimëve.

4. Fondet për krijimin dhe fillimin e punës së AKU-së garantohen nga Buxheti i Shtetit.

5. Fondet për ushtrimin e veprimtarisë së AKU-së përballohen nga:

a) Buxheti i Shtetit;

b) burime të tjera të brendshme ose donacione.

6. AKU-ja, me autorizim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ua delegon personave të tjerë juridikë, publikë veprimtarinë, në përputhje me objektivin e këtij autoriteti.

7. Organizimi dhe funksionimi i AKU-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Rekrutimi i nëpunësve të AKU-së bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Neni 62

Fusha e veprimtarisë së AKU-së

I. AKU-ja ka objekt të veprimtarisë analizimin e riskut për ushqimin dhe ushqimin për kafshë.

1. Në kuadër të veprimtarisë së vlerësimit të riskut, AKU-ja:

a) kërkon, grumbullon dhe analizon informacionin shkencor e teknik për të karakterizuar dhe monitoruar riskun, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi sigurinë e ushqimit dhe të ushqimit për kafshë;

b) kryen, në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik, Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe të Veterinarisë dhe me persona të tjerë juridikë, monitorimin e sigurisë së ushqimit dhe të ushqimit për kafshë;

c) kryen veprimtari për identifikimin dhe karakterizimin e riskut, që shfaqet për sigurinë e ushqimit dhe të ushqimit për kafshë;

ç) bën studime shkencore të nevojshme për promovimin e vlerësimit të riskut në fushën e sigurisë së ushqimit dhe të ushqimit për kafshë;

d) vendos mënyra unike të vlerësimit të riskut në të gjitha nivelet e prodhimit, të përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit e të ushqimit për kafshë.

2. Në kuadër të komunikimit të riskut, AKU-ja:

a) informon mbi riskun dhe jep mendimin shkencor për Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, institucionet e tjera publike dhe private, operatorët e biznesit ushqimor dhe të ushqimit për kafshë dhe konsumatorët, për sa u përket rreziqeve dhe sigurisë së ushqimit e të ushqimit për kafshë;

b) krijon një sistem informimi të shpejtë dhe, për këtë qëllim, merr e dërgon të gjithë informacionin për rreziqet e ushqimit, si dhe krijon një sistem qendror për shkëmbimin e informacionit.

3. Në kuadër të menaxhimit të riskut, AKU-ja bashkëpunon me Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për bashkërendimin e veprimtarive të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, për kryerjen e kontrollit zyrtar të sigurisë së ushqimit e të ushqimit për kafshë dhe për hartimin e kuadrit ligjor në fushën e sigurisë së ushqimit e të ushqimit për kafshë.

II. Krahas veprimtarive të përcaktuara në kreun I të këtij neni, AKU-ja:

1. Përgatit standarde, materiale informuese për praktikat e mira të prodhimit bujqësor, praktikat e mira të përpunimit, praktikat e mira të higjienës, për aplikimin e sistemit HACCP dhe për praktikat e mira laboratorike.

2. Ofron mendim shkencor për ushqimin, vlerat ushqimore të ushqimit dhe tema të tjera, që lidhen me shëndetin e mirëqenien e kafshëve, si dhe mbrojtjen e bimëve.

3. Bashkëpunon me institucione dhe organizma ndërkombëtarë, që trajtojnë çështjet e ushqimit.

4. Trajnon dhe certifikon inspektorët e kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Neni 63

Organet përbërëse të AKU-së

Organet përbërëse të AKU-së janë:

a) bordi

b) Drejtori i Përgjithshëm

c) komiteti shkencor dhe panelet shkencore

ç) inspektoratet dhe laboratorët përkatës

d) drejtoritë rajonale.

Neni 64

Struktura, mandati dhe detyrat e bordit

1. Bordi është përgjegjës për të siguruar që AKU-ja kryen misionin dhe përmbush detyrat e ngarkuara nga ky ligj. Ai përbëhet nga 15 anëtarë si më poshtë:

a) dy përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

b) një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;

c) një përfaqësues nga Ministria e Financave;

ç) një përfaqësues nga Ministria e Brendshme;

d) një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;

dh) një person publik në fushën e medias;

e) Kryetari i Shoqatës së Kryetarëve të Bashkive;

ë) pesë profesorë të fushave të ushqimit, të ushqimit për kafshë, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve nga universitetet;

f) një përfaqësues i shoqatës së konsumatorëve;

g) një përfaqësues i shoqatës së agrobiznesit.

2. Funksionet e përfaqësuesve të institucioneve të përfshira në bord, si dhe anëtarët e

përmendur në shkronjat “dh”, “ë”, “f” dhe “g” caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Anëtarët e bordit zgjidhen për një mandat 4-vjeçar.

4. Kryetari i bordit propozohet nga anëtarët e bordit dhe emërohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për një periudhë dyvjeçare.

5. Kriteret e emërimit dhe të shkarkimit, mënyra e funksionimit, të drejtat dhe detyrat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 65
Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së emërohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Drejtori i Përgjithshëm drejton veprimtarinë e AKU-së, e përfaqëson atë dhe vepron në emër të saj. Ai është përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë së AKU-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi; i paraqet propozime për dokumentacionin, që i dërgohet bordit, për miratimin e tyre; zbaton vendimet e bordit dhe kryen detyra të tjera, brenda kompetencave që ka, në zbatim të ligjit e të akteve nënligjore në fuqi.

3. Kriteret e emërimit e të shkarkimit dhe kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm përcaktohen me vendim te Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 66
Komiteti shkencor dhe panelet shkencore

1. Komiteti shkencor dhe panelet shkencore të AKU-së kanë në përbërje ekspertë, të cilët përcaktojnë mendimin shkencor për qëllime të veprimtarisë së këtij autoriteti.

2. Numri i paneleve shkencore, përbërja, funksionimi, të drejtat dhe detyrat e komitetit shkencor dhe të paneleve shkencore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Komiteti shkencor jep mendime shkencore:

a) me kërkesë të bordit;

b) me nismën e tij, për çështje brenda kompetencave që ka.

4. Kërkesa e paraqitur në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm, duke shpjeguar se cilës çështje shkencore i adresohet.

5. Komiteti shkencor jep mendimin e vet shkencor brenda periudhës së përcaktuar në kërkesën e bordit, me përjashtim të rastit kur rrethana objektive nuk e lejojnë këtë.

6. Në rastet kur:

a) është paraqitur më shumë se një kërkesë për të njëjtën çështje;

b) kërkesa për dhënien e mendimit shkencor nuk është shoqëruar me informacionin e nevojshëm ose është e paqartë;

c) komiteti shkencor ka dhënë mendimin e vet shkencor për një çështje të caktuar dhe ka vërejtur se nuk ka informacione të reja, që duhen vlerësuar,

komiteti shkencor mund ta refuzojë kërkesën ose të propozojë që kërkesa të ndryshohet. Kërkesa e refuzuar shoqërohet me një argumentim shpjegues.

Neni 67
Inspektoratet

Inspektorati i Kontrollit të Ushqimit dhe të Ushqimit për Kafshë, të shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve dhe laboratorët përkatës janë në përbërje të AKU-së. Këto inspektorate e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në nivel qarku, bashkie/komune, në përputhje me detyrat e përcaktuara, respektivisht, në këtë ligj, në ligjin për shërbimin veterinar dhe në ligjin e mbrojtjes së bimëve.

KREU XVI
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 68
Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga Inspektorati i Kontrollit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me gjobë, si më poshtë:

a) nxjerrja në treg e ushqimeve të reja, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 28 të këtij ligji, nga 1 milion deri në 3 milionë lekë;

b) etiketimi i ushqimeve të reja, në kundërshtim me nenin 36 të këtij ligji, nga 1 milion deri në 3 milionë lekë;

c) nxjerrja në treg e ushqimeve të reja për kafshë, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 54 të këtij ligji, nga 1 milion deri në 3 milionë lekë;

ç) etiketimi i ushqimeve të reja për kafshë, në kundërshtim me nenin 56 të këtij ligji, nga 1 milion deri në 3 milionë lekë;

d) nxjerrja në treg e ushqimeve, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 10 të këtij ligji, nga 3 milionë deri në 5 milionë lekë;

dh) importimi i ushqimeve, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 14 të këtij ligji, nga 3 milionë deri në 5 milionë lekë;

e) zhvillimi i biznesit në një stabiliment të paregjistruar, në kundërshtim me nenin 19 të këtij ligji, nga 3 milionë deri në 5 milionë lekë;

ë) veprimi në kundërshtim me kushtet e higjienës, të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji, nga 500 000 deri në 1 milion lekë;

f) veprimi në kundërshtim me kërkesat e vetëkontrollit, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 4 të nenit 26 të këtij ligji, nga 500 000 deri në 1 milion lekë;

g) hedhja në treg e ushqimit për kafshë të pasigurt, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 49 të këtij ligji, nga 500 000 deri në 1 milion lekë;

gj) veprimi në kundërshtim me kushtet e higjienës së ushqimeve, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji, nga 500 000 deri në 1 milion lekë;

h) veprimi në kundërshtim me kërkesat e gjurmueshmërisë, të përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji, nga 500 000 deri në 1 milion lekë;

i) përdorimi i shënimit “Produkt ushqimor tradicional”, në kundërshtim me nenin 33 të këtij ligji, nga 500 000 deri në 1 milion lekë;

j) etiketimi në kundërshtim me nenin 36 të këtij ligji, nga 500 000 deri në 1 milion lekë;

k) veprimi në kundërshtim me masat e përgjithshme të administrimit të kontrollit zyrtar të ushqimeve, të përcaktuara në pikat 2, 3 e 4 të nenit 43 të këtij ligji, nga 100 000 deri në 1 milion lekë.

2. Për shkelje të pikave 1, 2, 12 e 13 të nenit 19 të këtij ligji, përveç gjobës, mund të vendoset edhe masa e pezullimit të veprimtarisë deri në çastin e pajisjes me lejen përkatëse.

3. Në rastet kur është hedhur në treg ushqim, i cili është vërtetuar se ka shkaktuar dëm në shëndetin e njeriut, apo kur mund të përbëjë rrezik potencial për jetën e tij, sipas dispozitave të këtij ligji, ndaj operatorit të biznesit të ushqimit merret masa e heqjes së lejeve përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 69
Bllokimi dhe asgjësimi i ushqimit dhe ushqimit për kafshë

Ushqimi dhe ushqimi për kafshë, që nuk plotëson kërkesat e këtij ligji dhe që është bllokuar ose hequr nga tregu, asgjësohet me procesverbal të rregullt, sipas mënyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe shpenzimet përballohen nga operatori i biznesit ushqimor ose operatori i biznesit të ushqimit për kafshë, që ka bërë shkeljen.

Neni 70
Procedurat e kundërvajtjes administrative

1. Inspektorati i Kontrollit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë ka të drejtë të vendosë masa administrative.

2. Kundër vendimit të Inspektoratit të Kontrollit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë mund të bëhet ankim te Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e marrjes së njoftimit të vendimit. Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së duhet t'i përgjigjet ankimit brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së tij.

3. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, ose kur ky i fundit nuk përgjigjet brenda afatit 10-ditor, mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor, ku është kryer kundërvajtja, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e marrjes së njoftimit të vendimit.

4. Mënyra e vjeljes së gjobave dhe shpërndarja e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Kur Inspektorati i Kontrollit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë kërkon ndihmë, për shkak të zbatimit të detyrës së ngarkuar me ligj, ai mbështetet nga Policia e Shtetit, policia doganore dhe ajo tatimore.

KREU XVII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 71
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 21 pika 1, 25 pika 4, 27 pika 5, 31, 32 pika 3, 36 pika 3, 45 pika 2, 56 pika 2, 61 pika 7, 64 pikat 2 e 5, 65 pika 3 dhe 70 pika 4.

2. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, 16 pika 3, 17 pika 3, 18 pika 3, 19 pikat 4, 11, 12 e 13, 20, 23, 26 pikat 5 e 7, 28 pika 2, 29 pika 2, 30 pika 1, 33 pikat 2 e 4, 34 pika 2, 37 pika 3, 41 pika 12, 42 pika 3, 43 pika 7, 44 pika 4, 45 pikat 5 e 6, 47 pika 1, 50 pikat 1 e 2, 54 pika 4, 57 pika 4, 59 pika 10 dhe 66 pika 2.

Aktet nënligjore që nxjerr Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në zbatim të këtij ligji, bëhen me propozimin e AKU-së.

3. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Financave të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 17 pika 4.

4. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 54 pika 2.

Neni 72
Dispozita kalimtare

1. Deri në datën e fillimit të veprimtarisë së AKU-së, funksionet e saj ushtrohen nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Brendshme.

2. Deri në miratimin e akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr.7941, datë 31.5.1995 "Për ushqimin" dhe të ligjeve të tjera, që veprojnë në fushën e ushqimit.

3. Neni 25 "Kërkesat për gjurmueshmërinë e ushqimit" hyn në fuqi 1 vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Neni 26 "Kërkesat për sistemin e vetëkontrollit" hyn në fuqi 1 vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Neni 28 "Nxjerrja në treg e ushqimeve të reja", sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 27 dhe neni 54 "Hedhja në treg e ushqimit për kafshë, që kanë në përbërje ose përmbajnë OMGJ" hyjnë në fuqi 5 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 73
Shfuqizimet

1. Ligji nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin” shfuqizohet.

2. Ligji nr.8411, datë 1.10.1998 “Për ushqimet e blegtorisë” nuk zbatohet për kafshët që prodhojnë ushqim.

3. Në ligjin nr.7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”:

a) në nenin 13 shkronja “ç”, pjesa e fjalisë “kontrollon respektimin e normave higjienike të standardeve shtetërore dhe kushteve teknike të produkteve ushqimore e të artikujve të tjerë, të normave të të ushqyerit të grupeve të veçanta të popullsisë, si dhe miraton destinacionin e produkteve ushqimore me skadencë në limit ose të tejkaluar” shfuqizohet;

b) neni 19 paragrafi i parë shfuqizohet, me përjashtim të sapunëve dhe kozmetikës;

c) neni 20 shfuqizohet.

4. Në ligjin nr.9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështi”:

a) neni 9 “Organet përgjegjëse për dhënien e lejeve” shfuqizohet;

b) kreu VIII “Kontrolli” shfuqizohet;

c) neni 33 “Organet përgjegjëse për vendosjen e masave administrative” shfuqizohet.

5. Në ligjin nr.8944, datë 19.9.2002 “Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit”, neni 10 “Organet përgjegjëse për vendosjen e masave administrative” shfuqizohet.

6. Në ligjin nr. 8443, datë 21.1.1999 “Për vreshtarinë, verën dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi”, neni 34 shfuqizohet.

7. Në ligjin nr. 9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar” të gjitha nenet, pikat, fjalitë dhe fjalët ku trajtohet dhënia e lejeve, kontrolli, prodhimi, përpunimi dhe shpërndarja e produkteve ushqimore me origjinë shtazore shfuqizohen.

Neni 74
Hyrja në fuqi

Ky ligj, me përjashtim të nenit 72, i cili hyn në fuqi ditën e përfundimit të afatit të përcaktuar në këtë nen, hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5617, datë 13.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.9864, datë 28.1.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9426, DATË 6.10.2005 “PËR MBARËSHTIMIN E BLEGTORISË”

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj:

a) Emërtimi “Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit” zëvendësohet me emërtimin “Drejtoria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”.

b) Emërtimi “Drejtoria e Prodhimit Blegtoral” zëvendësohet me emërtimin “Sektori i prodhimit blegtoral”.

c) Emërtimi “Instituti i Kërkimeve Zooteknike” zëvendësohet me emërtimin “Qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore”.

Neni 2

Në nenin 3 shtohen pikat 63, 64 dhe 65 me këtë përmbajtje:

“63. “Sistem identifikimi” është sistemi i vetëm për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, i cili përbëhet nga këto elemente: materialet e identifikimit të kafshëve, regjistri i fermës, i përditësuar nga mbajtësi i kafshëve, dokumentet e lëvizjes së kafshëve, regjistri qendror ose baza kompjuterike e të dhënave.

64. “Certifikatë gjenealogjike” është dokumenti, që shoqëron kafshët dhe që përmban të dhëna për identifikimin dhe vlerat racore të kafshëve e të paraardhësve të tyre (prindërve dhe gjyshërve).

65. “Formulari i vetëdeklarimit” është formulari tip, i cili plotësohet nga çdo subjekt fizik ose juridik për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në fushën e blegtorisë.”.

Neni 3

Në nenin 6 pika 2 fjala “përmirësimin” zëvendësohet me fjalën “matjen”.

Neni 4

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Para ndërtimit ose rindërtimit të një objekti agroblegtoral, personat fizikë ose juridikë duhet ta miratojnë projektin teknologjik në drejtorinë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, si dhe të zbatojnë dispozitat e ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit””.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kur objekti agroblegtoral plotëson kriteret tekniko-teknologjike, drejtoria rajonale e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit lëshon lejen e ushtrimit të veprimtarisë për këtë objekt.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Drejtoria rajonale e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit mban regjistrin për fermat agroblegtorale, të dhënat e të cilit i dërgon, brenda muajit dhjetor të çdo viti, pranë drejtorisë përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Neni 5

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Për miratimin e programeve të shfrytëzimit të kullotave, për një periudhë 5-vjeçare, të propozuara nga shoqatat e bletërritësve, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ngrihet një komision teknik, në përbërje të të cilit janë:

a) një përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

b) një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;

c) një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme;

ç) një përfaqësues i Shoqatës Kombëtare të Bletërritësve;

d) një përfaqësues i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë.

Në program përcaktohen edhe rregullat për transportin e zgjojeve të bletëve, koha e shfrytëzimit të burimit, largësia e parqeve dhe ndërrimi i kullotës.

Rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e komisionit teknik përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.".

2. Në pikën 2 fjalët "Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit" zëvendësohen me fjalët "komisioni teknik".

3. Në pikën 3 fjalët "autoriteti kompetent në ministri" zëvendësohen me fjalët "inspektorati i zooteknisë pranë drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit".

Neni 6

Në nenin 21 pika 1 fjalët "sipas mënyrës së përcaktuar në programin racor" zëvendësohen me fjalët "sipas sistemit unik kombëtar".

Neni 7

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë të pikës 1, pas fjalës "publike" shtohen fjalët "dhe private".

2. Në pikën 4, pas fjalës "publik" shtohen fjalët "e privat".

Neni 8

Në nenin 23 pika 1 paragrafi i parë dhe pika 2 paragrafi i dytë, pas fjalës "publik" shtohen fjalët "e privat".

Neni 9

Në nenin 53 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Stacioni i ndërzimit natyror e ushtron veprimtarinë, nëse plotëson kërkesat e miratuara për personelin teknik, pajisjet, mjetet, riprodhuesit meshkuj dhe pasi të ketë paraqitur formularin e vetëdeklarimit pranë drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit të qarkut. Forma dhe përmbajtja e formularit të vetëdeklarimit përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.".

2. Në pikën 2, pas fjalës "natyror" shtohen fjalët "si dhe formulari i vetëdeklarimit".

Neni 10

Në nenin 56 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, pas fjalëve "Buxheti i Shtetit" shtohen fjalët "dhe/ose sektori privat".

2. Në pikat 5 e 6 fjalët "certifikatë racore prodhimi" zëvendësohen me fjalët "certifikatë gjenealogjike".

3. Në pikën 7, pas fjalëve "mënyra e financimit" shtohen fjalët "nga Buxheti i Shtetit".

Neni 11

Në nenin 57 bëhen këto ndryshime:

1. Në titull fjalët "procedurat e miratimit" zëvendësohen me fjalët "veprimtaria e".

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Qendrat e prodhimit të materialit racor e kryejnë veprimtarinë dhe funksionojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktin nënligjor të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.".

3. Në pikën 2 fjalët "në ministri" zëvendësohen me fjalët "në drejtorinë rajonale të bujqësisë,

ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit”.

4. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 58 pika 3, pas fjalëve “nga Buxheti i Shtetit” shtohen fjalët “dhe/ose sektori privat”.

Neni 13

Në nenin 59 pika 1, pas fjalëve “si shërbim publik” shtohen fjalët “dhe/ose privat”.

Neni 14

Në nenin 64 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4 shkronja “b” fjalët “që ka leje” zëvendësohen me fjalët “e miratuar”.

2. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Personat fizikë ose juridikë, të cilët merren me importin dhe eksportin e materialeve racore, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kriteret e përcaktuara me akt nënligjor të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe pasi të kenë paraqitur formularin e vetëdeklarimit pranë drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.”.

Neni 15

Në nenin 65 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“l. Drejtoria e Politikave të Prodhimit është autoriteti kompetent për zbatimin e këtij ligji dhe për ushtrimin e veprimtarive në fushën e blegtorisë, nëpërmjet:

a) sektorit të prodhimit blegtoral në ministri;

b) inspektoratit të zooteknisë në ministri dhe në drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit në qarqe;

c) qendrave të transferimit të teknologjive bujqësore;

ç) shërbimit këshillimor publik dhe/ose privat.”.

2. Në pikat 2 dhe 4 fjala “drejtoria” zëvendësohet me fjalën “sektori”.

Neni 16

Në nenin 66 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Sektori i prodhimit blegtoral në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore, sektorët e prodhimit bujqësor e blegtoral pranë drejtorive rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit në qarqe dhe shërbimi zooteknik privat janë përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.”.

Neni 17

Në nenin 68 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “drejtori i drejtorisë” zëvendësohen me fjalët “përgjegjësi i sektorit”.

2. Në pikat 2 e 3 fjalët “drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit” zëvendësohen me fjalët “drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit”.

Neni 18

Në nenin 73 pika 1 fjalët “Instituti i Kërkimeve Zooteknike” zëvendësohen me fjalët “qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore” dhe fjalët “Instituti i Kërkimeve Veterinare” zëvendësohen me fjalët “Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe i Veterinarisë”.

Neni 19

Në kreun VIII bëhen këto ndryshime:

Në titull fjalët “puna kërkimore” zëvendësohen me fjalët “transferimi i teknologjive”.

Neni 20

Në nenin 87 pika 1 shkronja “b” fjalët “institucionet kërkimore në fushën e bujqësisë” zëvendësohen me fjalët “qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore”.

Neni 21

Në nenin 89 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore”.

2. Pika l ndryshohet si më poshtë:

“1. Qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore në Fushë-Krujë e Korçë janë struktura të transferimit të teknologjive në blegtori, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në kuadër të programeve kombëtare të bujqësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit financon, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim, programet në fushën e blegtorisë.”.

4. Pika 3 shfuqizohet.

5. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë -Krujë është qendër e referencës kombëtare për:

a) kontrollin e ushqimeve që përdoren në blegtori;

b) kontrollin e materialeve racore (spermë, vezë, embrione).”.

6. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore realizojnë veprimtarinë e tyre në zbatim të politikave të zhvillimit të prodhimit blegtoral.”.

7. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 22

Në nenin 91 fjalët “Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” zëvendësohen me fjalët “drejtorit të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit”.

Neni 23

Në nenin 97 pika 2 numri “61” zëvendësohet me numrin “63”.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5618, datë 13.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.9865, datë 31.1.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE SELISË SË SHENJTË PËR DISA ÇËSHTJE EKONOMIKE DHE TATIMORE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për disa çështje ekonomike dhe tatimore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5616, datë 12.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SELISË SË SHENJTË MBI DISA ÇËSHTJE EKONOMIKE DHE TATIMORE

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë me vullnetin e përbashkët për të forcuar marrëdhëniet reciproke, duke iu referuar parimeve të njohura në shkallë ndërkombëtare të lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, duke vlerësuar kontributin e rëndësishëm shoqëror, moral dhe historik të Kishës Katolike në jetën e vendit, me qëllimin për të përcaktuar një kuadër ligjor përkatës për ecurinë normale të veprimtarive të Kishës Katolike në Shqipëri, u morën vesh mbi nevojën për të arritur në një Marrëveshje për të rregulluar më mirë disa çështje me natyrë ekonomike dhe tatimore.

Palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Republika e Shqipërisë garanton të drejtën që i është njohur Kishës Katolike në Shqipëri për të zotëruar dhe për të administruar në mënyrë të pavarur të mira dhe burime ekonomike të nevojshme për zhvillimin e misionit të vet.

Neni 2

Kisha Katolike lirisht mund të sigurojë dhe të marrë ndihma materiale ose financiare të ardhura nga besimtarë dhe dhurues, edhe nga jashtë shtetit. Ajo mund të organizojë mbledhje ndihmash publike dhe të pranojë lëmosh, të cilat do t'i shërbejnë për zhvillimin e misionit të saj. Subvencionet financiare të çfarëdolloji dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme, si edhe donacionet materiale, të destinuara për të realizuar misionin e vet, nuk do t'i nënshtrohen asnjë lloj takse apo tatimi.

Neni 3

Janë të përjashtuara nga taksa mbi ndërtesën, ndërtesat në pronësi ose në përdorim të Kishës Katolike, të enteve të saj dhe të institucioneve të saj të parashikuara në Kodin e së Drejtës Kanonike, të themeluara nga autoriteti kompetent kishtar si persona juridikë kishtar ose të njohura si organizata pa qëllim fitimi të Kishës Katolike dhe të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore shqiptare, në rastet kur ato përdoren për ushtrimin e kultit, drejtimin dhe administrimin kishtar, veprimtarinë baritore, humanitare dhe bamirëse, formimin e meshtarëve dhe të rregulltarëve, mësimin e teologjisë dhe të shkencave të tjera kishtare, si dhe për banimin e mbarështuesve të kultit dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kishës.

Neni 4

Përjashtimet e parashikuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje nuk do të zbatohen në rast se ndërtesat në të, të përmendura, do të përdoren për veprimtari që kanë qëllim fitimi. Në këtë rast do të zbatohet legjislacioni në fuqi duke mbajtur parasysh tarifat e caktuara prej organeve të pushtetit lokal.

Neni 5

Për ndërtesat dhe ambientet e caktuara për veprimtari edukative dhe shkollore, edhe universitare e pasuniversitare, shoqërore dhe shëndetësore, në pronësi ose në përdorim të enteve dhe të institucioneve të parashikuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohet tarifa e caktuar prej organeve të pushtetit lokal, e cila nuk duhet të jetë më e madhe se tarifa e përcaktuar për organizatat e tjera pa qëllim fitimi që zhvillojnë të njëjtat veprimtari, duke llogaritur vetëm sipërfaqen e ambientit në të cilin zhvillohen veprimtaritë e parashikuara.

Neni 6

Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të Kishës Katolike ose të enteve të saj, të përdorura për ushtrimin e kultit, drejtimin dhe administrimin kishtar, veprimtarinë baritore, humanitare dhe bamirëse, formimin e meshtarëve dhe të rregulltarëve, si dhe për banimin e mbarështuesve të kultit dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kishës do të përjashtohen nga pagimi i taksës së trashëgimisë ose të kalimit të pasurisë, në rastin e dhurimeve mes Kishës Katolike dhe enteve të saj, ose mes vetë enteve të parashikuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje. Destinacioni i pasurive të sipërpërmendura do të provohet me aktet noteriale përkatëse.

Neni 7

Përjashtohen nga detyrimi i derdhjes së kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor mbarështuesit e kultit dhe personeli fetar dhe laik në shërbim të Kishës, me kombësi të huaj, me banim të rregullt në Shqipëri, të cilët nuk përfitojnë asnjë të ardhur apo shpërblim për kryerjen e veprimtarisë së tyre në shërbim të Kishës, edhe në cilësinë e themeluesve, të drejtuesve apo të përfaqësuesve ligjorë të enteve apo institucioneve të parashikuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe që i kanë derdhur më parë këto kontribute në vendet e origjinës. Subjekteve të sipërpërmendura do t'i takojë detyrimi për ta provuar këtë me dokumente pranë organeve shtetërore kompetente.

Neni 8

Personat juridikë kishtar të Kishës Katolike, të parashikuar në Kodin e së Drejtës Kanonike ose të njohura prej Autoritetit kompetent kishtar dhe të regjistruar pranë organeve shtetërore përkatëse, përsa i takon veprimtarive të tyre me karakter institucional si: ushtrimi i kultit, drejtimi dhe administrimi kishtar, veprimtaria baritore, humanitare dhe bamirëse, formimi i meshtarëve dhe i rregulltarëve, mësimi i teologjisë dhe i shkencave të tjera kishtare, nuk janë të detyruar të mbajnë regjistrat kontabël dhe t'u nënshtrohen standardeve administrative të parashikuara në ligjet dhe në aktet nënligjore në fuqi. Si pasojë, për të tilla veprimtari ato nuk e kanë detyrimin që të paraqesin bilancin kontabël vjetor tek organet kompetente shtetërore dhe as ta depozitojnë atë pranë organizmave shtetërorë të caktuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 9

Në rast çështjesh të papërcaktuara, të pazgjidhura dhe të diskutueshme që kanë të bëjnë me Kishën Katolike në Shqipëri dhe me Entet dhe Institucionet e saj si persona juridikë kishtar ose të njohura si organizata pa qëllim fitimi të Kishës Katolike dhe të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore shqiptare, Kisha Katolike në Shqipëri dhe autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të formojnë një komision dypalësh "*ad-hoc*" me detyrën për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga të dyja Palët.

Neni 10

Në rast se në të ardhmen, për shkaqe ose rrethana të ndryshme, do të bëhet i nevojshëm rregullimi i çështjeve të tjera me natyrë ekonomike dhe tatimore të paparashikuara në këtë Marrëveshje, Palët nënshkruese do të bien dakord për të firmosur marrëveshje shtesë.

Neni 11

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në momentin e njoftimit reciprok për plotësimin nga ana e secilës Palë të procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi.

Kjo Marrëveshje do të zgjidhet nëse njëra Palë do t'i njoftojë Palës tjetër vendimin e saj me shkrim. Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari pas 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 3 dhjetor 2007.

Për Republikën e Shqipërisë	Për selinë e Shenjtë
Ministri i Financave	Nunci Apostolik
Ridvan Bode	Arqipeshkvi Giovanni Bulaitis

VENDIM
Nr.109, datë 3.2.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA MAMINAS TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VEND0SI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Maminas të qarkut të Durrësit, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë e që përfundon me numrin rendor 25 (njëzet e pesë) dhe lidhja nr.1, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikes së Shqipërisë dhe komuna Maminas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARE PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Sipas inventarizimit te pronave te veçanta te tipit,Pyje,Kullota,Livadhe,Shkembore etj)

Instuticioni I Pushtetit Qendrore: M.M.P.A.U

Komuna Maminas

Nr. Rend	Nr. i prones sipas VKM	Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe kullosore (EPK)	Emertesa e Ngastres Vend ndodhja (sipas emertëses popullore)	Numri i ngastres	Destinacioni	Siperfaqja ne ha	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	97	Komuna Maminas	Gryka e Kenetes	57	Pyll prodhues	31.94	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
2	98	Fshati Rubjeke, Kareç etj	Gryka e Kenetes	58	Pyll prodhues	33.04	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
3	99	Fshati Rubjeke, Kareç etj	Gryka e Kenetes	59	Pyll prodhues	26.46	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
4	100	Fshati Rubjeke, Kareç etj	Gryka e Kenetes	60	Pyll prodhues	18.98	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
5	101	Fshati Rubjeke, Kareç etj	Gryka e Kenetes	61	Pyll prodhues	20.99	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
6	102	Fshati Rubjeke, Kareç etj	Gryka e Gerdecit	63	Pyll prodhues	11.97	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
7	103	Fshati Rubjeke, Kareç etj	Gryka e Gerdecit	64	Pyll prodhues	20.01	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
8	104	Fshati Rubjeke, Kareç etj	Gryka e Gerdecit	65	Pyll prodhues	20.4	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
9	105	Fshati Rubjeke, Kareç etj	Gryka e Gerdecit	66	Pyll prodhues	18.67	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
10	106	Fshati Rubjeke, Kareç etj	Gryka e Gerdecit	67	Pyll prodhues	6.87	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
11	107	Fshati Bodinat	Sharra e Gjate	17	Pyll prodhues	21.32	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
12	108	Fshati Bodinat	Kodra e Rame Memes	18a	Pyll prodhues	24.11	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
13	109	Fshati Bodinat	Kodra e Rame Memes	18b	Pyll prodhues	3.4	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
14	110	Fshati Bodinat	Kodra e Rame Memes	19a	Pyll prodhues	16.51	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
15	111	Fshati Bodinat	Kodra e Rame Memes	19b	Pyll prodhues	2.39	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
16	112	Fshati Bodinat	Kodra e Rame Memes	20a	Pyll prodhues	24.76	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
17	113	Fshati Bodinat	Kodra e Rame Memes	20b	Pyll prodhues	2.76	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
18	114	Fshati Bodinat	Kodra e Rame Memes	21a	Pyll prodhues	34.02	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
19	115	Fshati Bodinat	Kodra e Rame Meese	21b	Pyll prodhues	1.2	Lende,dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
20	116	Fshati Bodinat	Shullani i Shtrazes	22	Pyll prodhues	14.96	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
21	117	Fshati Bodinat	Shullani i Shtrazes	23a	Pyll prodhues	6.34	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
22	118	Fshati Bodinat	Shullani i Shtrazes	23b	Pyll prodhues	11.38	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
23	119	Fshati Bodinat	Shullani i Bodinatit	24a	Pyll prodhues	18.62	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
24	120	Fshati Bodinat	Shullani i Bodinatit	24b	Pyll prodhues	3.04	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004
25	121	Fshati Bodinat	Shullani i Bodinatit	25	Pyll prodhues	14.99	Per dru zjarri	MMPAU	D.SH.P.	Kaluar Komunes ne vitin 2004

Njesia e Qeverisjes Vendore Maminas **Lidhja 1**

Numrat rendore te pronave ne listen e inventarit	Fusha e perdorimit te prones	Lloji i transferimit
97-121	Pyll dhe Kullote	Pronesi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 600 lekë
2. REGJISTRAT E NOTERISË 1000 lekë

BOTIME TË REJA
(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë

- Vendime të Gjykatës Kushtetuese 700 lekë
- Vendime të Gjykatës së Lartë 1000 lekë
- Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil 200 lekë
- Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave 273 lekë
- Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme
  (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)

Hyri në shtyp më 18.2.2008
Doli nga shtypi më 18.2.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë